



Përkrahja për organizatat lokale të shoqërisë civile –  
nismat e drejtësisë tranzicionale dhe ndërtimi i besimit në Ballkanin  
Perëndimor – Rrjeti i pajtimit KOMRA

**Udhëzues për paraqitjen e projekt-propozimeve**  
Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, Serbia dhe Maqedonia e Veriut

**Afati për dorëzimin e aplikimeve: 20.09.2023**



**Funded by  
the European Union**

# 1. Rrjeti i pajtimit KOMRA

## 1.1. Konteksti

Rrjeti i pajtimit KOMRA (RRPK), ish Koalicioni për KOMRA-n mbledh organizatat e shoqërisë civile, artistët, shkrimtarët, historianët, juristët dhe individë të tjerë, të cilët me aktivitetet dhe me angazhimin e tyre publik e mbështesin regjistrin emër për emër të të gjitha viktimave të luftërave të viteve 1991-2001 në hapësirën e ish-Jugosllavisë. Përkrahjen për regjistrin rajonal të viktimave të luftës e kanë dhënë 580.000 qytetarë të vendeve post-jugosllave, të cilët në vitin 2011 e kanë nënshkruar peticionin për themelimin e KOMRA-së. Deri në vitin 2015, liderët e Kroacisë, Serbisë, Malit të Zi, Kosovës dhe të Maqedonisë (Maqedonisë Veriore të tashme) si dhe dy anëtarë të Presidencës së Bosnjes dhe Hercegovinës, e kanë mbështetur nismën qytetare që shtetet bashkërisht të regjistrojnë të gjitha viktimat e luftës.

Koalicioni për KOMRA-n, në muajin dhjetor të vitit 2014 e ka miratuar Projekt Statutin e KOMRA-s, të cilin paraprakisht e kanë harmonizuar të dërguarit e liderëve të vendeve të cekura dhe ekspertët e Koalicionit për KOMRA-n si dokument për fillimin e procedurës për themelimin e KOMRA-s. Megjithëkëtë, ndryshimet politike në Kroaci, në muajin shkurt të vitit 2015, kanë çuar deri te kthesa e madhe e këtij vendi në ballafaqimin me të kaluarën – Kroacia është përcaktuar për ballafaqimin kombëtar me të kaluarën, me çka përkrahja politike nismës për KOMRA-n dukshëm është dobësuar.

Në pajtim me marrëveshjen me liderët e vendeve të tjera post-jugosllave, Koalicioni e ka përgatitur Deklaratën për themelimin e KOMRA-s, me propozimin që në samitin e Procesit të Berlinit në Londër në vitin 2018 ta nënshkruajnë ministrat e punëve të jashtme të Ballkanit Perëndimor, duke shpresuar që Kroacia, si anëtare e BE-së, do të inkuadrohet më vonë. Megjithëkëtë, vendimin e qeverisë për nënshkrimin e Deklaratës e ka sjellë vetëm Mali i Zi, arsye kjo përse nënshkrimi i Deklaratës është hequr nga rendi i ditës së samitit të Procesit të Berlinit në vitin 2018.

Pastaj ka rezultuar mbështetja e dukshme e Drejtorisë së BE-së për politikën e fqinjësisë dhe të zgjerimit të BE-së. Në kuadër të përgatitjeve për samitin e Procesit të Berlinit në vitin 2019, drejtori gjeneral i nderit i KE, Pierre Mirel, në emër të Drejtorisë së BE-së për politikën e fqinjësisë e ka vizituar Sarajevën ku është informuar nga këshilltarët e anëtarëve të Presidencës së Bosnjes dhe Hercegovinës se anëtari boshnjak dhe kroat i Presidencës kanë prioritete të reja - sigurimin e stabilitetit dhe të sigurisë rajonale për Bosnjen dhe Hercegovinën dhe se Republika Srpska nuk e mbështet pajtimin në bazë të fakteve gjyqësore, për të cilat angazhohet Koalicioni për KOMRA-n.

I ballafaquar me ndërprerjen e mbështetjes politike, Kuvendi i Koalicionit në muajin dhjetor të vitit 2019, në mbledhjen e tij të XII-të, e ka sjellë vendimin mbi rekonstruktimin e Nismës KOMRA - marrjen përsipër të brengës për hartimin e regjistrit rajonal të viktimave (130.000), me anë të rritjes së kapaciteteve hulumtuese përmes përfshirjes së fakulteteve të shkencave shoqërore nga Kroacia dhe Bosnja dhe Hercegovina, dhe me sigurimin për mjetet përkatëse financiare.

Sipas të dhënave të RrPK, identiteti i së paku 27.500 viktimave të luftës tashmë është vërtetuar: identiteti i rreth 7.000 viktimave të luftës është vërtetuar me anë të aktgjykimeve gjyqësore, Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH) dhe Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) nga shumë burime e kanë konstatuar identitetin e 13.500 viktimave civile e ushtarake në lidhje me luftën në Kosovë, kurse Documenta dhe FHP identitetin e rreth 7.000 viktimave civile e ushtarake në luftën në Kroaci.

Një pjesë e madhe e punës është kryer, por është më se e nevojshme që sa të jetë e mundur më parë të kryhet regjistrimi i të gjitha viktimave dhe që të dhënat të jenë publikisht të qasshme për verifikim. Për një punë të këtillë të rëndësishme është thelbësore një mbështetje më e fuqishme për nismat në nivel lokal, të cilat e promovojnë perspektivën e viktimave dhe të drejtësisë, pajtimin rajonal, respektimin e viktimave pa marrë parasysh përkatësinë etnike, dhe që nxisin të rinjtë të mësojnë, të mbajnë mend dhe të mendojnë në mënyrë kritike për të kaluarën. Nga kjo rezulton projekti i granteve të vogla, që i kanë menduar anëtarët e RrPK-së, të cilat marrin pjesë në hulumtimin e humbjeve njerëzore dhe të vendeve të ngujimit – Fondi për të Drejtën Humanitare (Serbi), Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (Kosovë), Shoqata për Drejtësinë Tranzicionale, Pajtimin dhe Përkujtimin në B dhe H, dhe Qendra për Demokraci dhe Drejtësi Tranzicionale (B dhe H), Qendra për Edukim Qytetar (Mali i Zi) dhe Instituti për Politikë Evropiane (Maqedonia e Veriut).

## 1.2. Qëllimet

Qëllimi i përgjithshëm është zhvillimi i rrjetit të shoqërisë civile për pajtimin në hapësirën e ish-Jugosllavisë, të vendosur „nga poshtë-lartë“, që i vendos viktimat në plan të parë.

Qëllimet specifike janë përforcimi i pozitës dhe i zërit të të rinjve, grave, viktimave dhe organizatave të shoqërisë civile në nivel lokal në lidhje me pajtimin rajonal dhe shkëmbimi trans-rajonali i njohurive dhe i praktikave të mira.

Dërgojeni propozimin e nismës, e cila i kontribuon në zgjerimin e njohurive mbi faktet gjyqësore dhe përforcimit të zërit të viktimave, pranimit dhe zbulimit të fakteve dhe të krimeve të luftës në bashkësinë lokale, ndërtimit të kulturës së përkujtimit dhe pajtimit rajonal.

## 1.3. Korniza financiare

Shuma totale e fondeve për zbatimin e Thirrjes të tretë të rinovuar është 43.000 EUR, dhe shuma më e madhe e granteve individuale është 7.000 EUR.

## 2. Kriteret për pjesëmarrje

### 2.1. Bartësit e aplikacioneve

Për pjesëmarrje mund të aplikojnë organizatat e shoqërisë civile:

- të cilat kanë statusin e subjektit juridik në përputhje me rregullat kombëtare në fuqi në Bosnjë e Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Serbi, Kosovë ose në Mal të Zi;
- jofitimprurëse;
- organizata të shoqërisë civile;
- aktive në nivel të bashkësisë lokale;
- që disponojnë me kapacitete të mjaftueshme organizative dhe që janë drejtpërdrejtë përgjegjëse për përgatitjen dhe për realizimin e projektit (partner, nëse i ka).

Organizatata, të cilat aplikojnë, duhet të plotësojnë kushtet e cekura në mënyrë kumulative.

Organizatat mund të aplikojnë në mënyrë individuale ose me organizata të tjera. Partneritetet dhe rrjetëzimet nuk janë kusht për aplikim.

Partnerët, nëse janë pjesë e projektit, duhet të plotësojnë të njëjtat kushte si edhe organizatat, të cilat dorëzojnë projekt-propozimint.

Partitë politike, organizatat ndërkombëtare, institucionet qeveritare, bashkësitë fetare dhe organizatat joformale nuk mund të aplikojnë në këtë thirrje.

Organizatat duhet të kenë përvojë aktiviste në fushën e të drejtave të njeriut dhe/ose të drejtësisë tranzicionale. Përparësi kanë organizatat me përvojë në realizimin e aktiviteteve për vendosjen e drejtësisë tranzicionale dhe projektet, të cilat merren me çështjet gjinore, me të rinjtë dhe/ose me viktimat, si dhe projektet, të cilat do të zbatohen në vende më të vogla.

## **2.2. Projektet**

Për shembull, projektet në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Serbi dhe Kosovë mund të jenë:

- hulumtimi i krimeve në të cilat janë vrarë persona mbi 60 vjeç, persona të palëvizshëm, persona me aftësi të kufizuara, persona me nevoja të veçanta, gratë;
- hulumtimi i akteve të trajtimit johuman dhe çnjerëzor ndaj të burgosurve bazuar në bazën e të dhënave të ICTY dhe dokumentacionin e gjykimeve vendase;
- koleksioni dixhital i intervistave me dëshmitarë të ngjarjes (një krim që nuk ishte objekt gjykimi);
- hartëzimi i vendeve të pashënuara të bazuar në fakte gjyqësore dhe kërkime në terren;
- film dokumentar, ekspozitë, libër, animacion dhe projekte të tjera që kontribuojnë në pajtimin rajonal dhe ndërtimin e një kulture të përbashkët të kujtesës të luftërave të viteve të nëntëdhjeta.

Projektet në Maqedoninë e Veriut mund të jenë:

- lidhja e dialogut për ndikimin e luftës në një qytet apo lagje të caktuar, të cilin organizatat joqeveritare do ta udhëhiqnin përmes takimeve të organizuara të grupeve të ndryshme të interesit në nivel lokal në formën e një diskutimi për pajtimin dhe ndërtimin e paqes;
- arritja e bashkëpunimit me shkollat përmes procesit të planifikimit të aktiviteteve jashtëshkollore mbi temën e ndërtimit të paqes (debate, punëtori kreative, etj.) në kuadër të lëndës së edukimit qytetar;
- fushata lokale të rinisë për ndërtimin e paqes;
- vendosja e një dialogu me grupet e ndryshme, kryesisht gratë, romët, popullatën LGBTI në lidhje me përdorimin e narrativave të ndryshme në sferën publike dhe analizën e tyre;
- rrjetëzimi i grupeve të të rinjve me përkatësi të ndryshme etnike me qëllim të ndërtimit të besimit, vendosjes së dialogut për pajtim dhe ndërtimit të paqes.

Nuk do të merren në shqyrtim:

- mbështetja financiare e individëve për pjesëmarrje në punëtori, seminare, konferenca, kongrese;
- stipendimi i individëve për studime, trajnime, vizita studimore ose pjesëmarrje në ngjarjet ndërkombëtare;
- aktivitetet promovuese;
- projektet infrastrukturore ose furnizimi me pajisje;

- blerja dhe/ose renovimi i objekteve ose i zyrave;
- aktivitetet e realizuara para nënshkrimit të kontratës;
- aktivitetet e orientuara drejtë arritjes së përfitimeve;
- donacionet dhe ndihma humanitare;
- aktivitetet, të cilat tashmë janë mbështetur financiarisht në kuadër të programeve të tjera të BE-së;
- kërkesat për bashkëfinancim.

### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e zbatimit të projektit është maksimumi pesë (5) muaj, duke përfunduar në fund të shkurtit 2024.

### **Lokacioni**

Organizatat, të cilave do t'iu miratohen projektet, aktivitetet i realizojnë në shtetin në të cilin e kanë selinë. Pos kësaj, aktivitetet mund të realizohen edhe në një ose më shumë shtete të përfshira në thirrje – në Bosnjë e Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Serbi, Mal të Zi dhe/ose në Kosovë.

### **Numri i propozimeve të projekteve dhe granteve për një organizatë**

Organizata nuk mund paraqes më shumë se një projekt-propozim në kuadër të kësaj Thirrjeje. Partneri nuk mund të paraqesë më shumë se një projekt-propozim në kuadër të kësaj Thirrjeje.

## **3. Aplikimi**

### ***3.1. Përmbajtja e aplikimit***

Projekt propozimet duhet të jenë në gjuhën angleze ose në gjuhën zyrtare të ndonjërit prej vendeve të përfshira në thirrje.

Aplikacionin e përbëjnë:

- ⇒ certifikata e skanuar mbi regjistrimin, e lëshuar nga ana e institucionit kompetent;
- ⇒ projekt-propozimi në formën finale;
- ⇒ propozimi i buxhetit.

### ***3.2. Si të aplikohet***

Aplikimet dërgohen në mënyrë elektronike, me e-mail në [recom.call@cgo-cce.org](mailto:recom.call@cgo-cce.org), me titullin (subjektin): *Përkrahja për organizatat lokale të shoqërisë civile – Rrjeti i Pajtimet KOMRA.*

Aplikimet jo të plota dhe të paraqitura pas afatit nuk do të shqyrtohen.

### **3.3. Afati për aplikim**

Afati për paraqitje të aplikimit dhe të projektit është 20.09.2023.

Pyetjet dërgohen në mënyrë elektronike në [recom.call@cgo-cce.org](mailto:recom.call@cgo-cce.org), deri me 12.09.2023.

## **4. Vlerësimi dhe zgjedhja**

Aplikimet do t'i shqyrtojë dhe vlerësojë Komisionit përzgjedhës, të cilin e emëron koordinatorja e projektit.

Në fazën e parë, do të bëjnë verifikimin administrativ të dokumentacionit, që kërkohet me Thirrje. Vetëm aplikimet e plota do të kalojnë në fazën e dytë të evaluimit, që do të bëhet sipas kritereve paraprakisht të konstatuara, prej të cilave më të rëndësishmet janë dimensionin rajonal, kontributi në zvogëlimin e etnoizimit të viktimave, kontributi për informimin e publikut për krimet e luftës dhe faktet e vërtetuara nga gjyqi, kapacitetet për realizimin e projektit.

## **5. Lajmërimi mbi vendimin**

Të gjithë pjesëmarrësit e thirrjes do të njoftohen për vendimin e Komisionit përzgjedhës të projektit me e-mail, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të thirrjes.